



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 426/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e SH.P.K. Sfinga nga Prizreni, paraqitur kundër subjekteve politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizrenë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizrenë, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Kosovo Turk Adaleti Partisi (KTAP) Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) Bashkimi Demokratik (BD) Ujedinjena Stranka Boshnjaka (USB) dhe Vakrat për shkak të shfrytëzimit dhe dëmtimit të reklamave, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Hidhet si e pas afatshme** ankesa e SH.P.K. “Sfinga” nga Prizreni.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.10.2013, nëpërmjet postës KOEX të parashtruar në këtë postë me datën 01.11.2013 nga SH.P.K. Sfinga nga Prizreni, në të cilën theksohet se shumë nga kandidatët e partive të ndryshme që kandidojnë në zgjedhjet 2013 për kuvend të komunës po shfrytëzojnë pa leje dhe pa të drejtë hapësirat në reklamat që janë pronë e kësaj ndërmarrje për të cilat paguajnë qira në bazë të kontratës që kanë me komunën e Prizrenit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se gjatë vendosjes së këtyre posterëve ka ardhur deri te dëmtimet e llamarinës së aluminit pasi që ajo nuk është paraparë për vendosjen e këtyre posterëve. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon që të ndermirren veprimet konkrete në drejtim të mbrojtjes së pronës private dhe të kompensimit për sanimin e dëmeve e që sipas parashtruesit të ankesës kapin shumën në vlerë prej 600 €

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pa afatshme pasi që neni 3.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it parasheh që për të gjitha çështje që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin ankesa duhet të dorëzohet në PZAP

brenda 72 orëve nga shkelja e pretenduar, andaj ngjarja për të cilin pretendon pala ankuese ka ndodhur me datën 28.10.2013, ndërsa ankesa në postën KOEX për tu dorëzuar në PZAP është dorëzuar me datën 01.11.2013 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 72 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP nga shkelja e pretenduar, prandaj në kuptim të nenit 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 426/2013 më datën 04.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*